



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr.01/97

Datë: 22.05.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010 dhe Ligjit të Punës nr.03/L-212, neni 59 (kompensimi i pushimit mjekësor), nenit 11 pika 1 e Ligjit të Buxhetit për vitin 2026, si dhe Udhëzuesin për zëvendësimin dhe pagesën e mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore nr.2-2531 të datës 27.08.2024 (MASHT), Mbështetur në Kërkesën nga z. Bekim Gaxherri Drejtor i SHFM “Edmond Hoxha” në Junik, me nr.7-155/3418 të datës 18.05.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. z. Tafë Krasniqi, mësimdhënës në SHFMU “Edmond Hoxha”, lirohet nga puna me pagesë në lartësi prej 100% të pagës për periudhën nga data 10.04.2026 deri më 14.06.2026, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore.
- II. Gjatë kësaj periudhe, i njëjti gëzon të drejtën e pagesës së plotë, në pajtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

A R S Y E T I M

Nga kërkesa e z. Bekim Gaxherri Drejtor i SHFM “Edmond Hoxha” në Junik, me nr.7-155/3418 të datës 18.05.2026, të bashknagjitur raportet mjekësore specialistike me nr. 2874-2151 të datës 10.04.2026 dhe nr. 3914-2877 të datës 11.05.2026 është konstatuar gjendja e rëndë shëndetësore e mësimdhënësit Tafë Krasniqi është rekomanduar pushim mjekësor.

Duke u bazuar në kërkesën, dokumentacionin mjekësor specialistik, si dhe në dispozitat e Ligjit të Punës dhe Udhëzuesit për zëvendësimin dhe pagesën e mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore nr. 2-2531 të datës 27.08.2024, Komuna e Junikut- Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për lirimin nga puna me pagesë për periudhën e lartcekur.

Në rast se gjatë kësaj periudhe përmirësohet gjendja shëndetësore e mësimdhënësit, i njëjti mund të kthehet në vendin e tij të punës, bazuar në raportet përkatëse mjekësore.

Nëse pas përfundimit të periudhës së lirimit nga puna vazhdon gjendja e rënduar shëndetësore, mësimdhënësi obligohet të paraqesë dokumentacion të ri mjekësor, me qëllim të shqyrtimit të mundësisë për vazhdimin e lirimit nga puna, gjithnjë në përputhje me raportet mjekësore dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Me vendin njoftohet:

- z. Tafë Krasniqi;
- Drejtoria për AKRS;
- SHFM “Edmond Hoxha”;
- Arkivi .

